



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 802//10 prot.

Datë 11/08//2022

V E N D I M

Nr. 773/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11/08//2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “NISATEL” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar / shërbime”, me Nr. REF-23685-03-31-2022, me objekt “Sherbimi i Internetit ne Bashkine Lezhe per vitin 2022” me fond limit 1.001.572 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 11.04.2022, nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë.

Ankimues: Operatori ekonomik “NISATEL” SHPK
Adresa: Lagjja Pavarësia, Kulla e parë, tek Rrethi Skelë kati 2, Vlorë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Lezhë
Adresa: Lagjia “Skenderbeg”, Sheshi “Gjergj Kastrioti” 4501, Lezhë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nwn kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.04.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit *E hapur e thjeshtuar / shërbime*”, me Nr. REF-23685-03-31-2022, me objekt “*Sherbimi i Internetit ne Bashkine Lezhe per vitin 2022*” me fond limit 1.001.572 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 11.04.2022, nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë.

II.2. Në datë 11.04.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 12.04.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ALBTELECOM” SHA	0	lekë	skualifikuar
2. “NISATEL” SHPK	495.000	lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 12.04.2022, operatori ekonomik "NISATEL" SHPK është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave. Operatori ekonomik "NISATEL" SHPK është skualifikuar me argumentet e mëposhtme:

"III- Operatori Ekonomik "NISATEL" me Nuis K26330201T.

Nga verifikimi nw SPE rezulton se:

Së pari, nuk plotëson kriterin 2.3.3, të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: *Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar për pajisjet e kërkuara. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se për plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizimin/aktin e marrëveshjes me prodhuesin ose distributorin e autorizuar dhe në rast të paraqitjes së autorizimit/marrëveshjes nga distributori duhet të bashkëngjisin edhe autorizimin/aktin e marrëveshjes ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, konstatohet se OE ka paraqitur autorizim distributori nga subjektet "Albamedia" Sh.p.k dhe "Reg" Shpk, por nuk ka bashkëngjitur asnjë dokument që provon se këta subjekte janë distributorë për pajisjet e kërkuara.

KVO thekson se krahas paraqitjes së autorizimit të distributorit, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizimin/aktin e marrëveshjes ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar, pasi autorizimi i distributorit, i paraqitur nga OE nuk provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit.

Sa më sipër ky kriter konsiderohet i papërbushur

Së dyti, nuk plotëson kriterin 2.3.5 të kushteve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik si më poshtë:

a- Të paktën 2 (dy) Inxhinier Elektronik/Kompjuterik (Diplomë Universitare)

Për plotësimin e këtij kriteri OE-të duhet të paraqesin: Diplomat, sipas shënimeve të mësipërme, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën për periudhën Janar 2022 – Shkurt 2022.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit.

KVO vëren se bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parshikohet se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, si dhe bazuar në pikën 2/h të nenit 26 të VKM-së 285, ku parshikohet se

Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti) dhe për të përmbushur këtë kriter operatorët ekonomik pjesmarrës duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së, të dhënat mbi profesionin e stafit të punësuar që disponon sipas përcaktimeve të mësipërme.

Autoriteti Kontraktor, mban në konsideratë se për plotësimin e këtij kriteri nuk mund të shqyrtojë dokumentacion tjetër përveç formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pasi ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së, dhe për vlerësimin e këtij kriteri KVO duhet ti referohet vetëm formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

KVO bazuar në pikën 1, të nenit 82, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit”, verifikoi formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE ku rezulton se Operatori Ekonomik, nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të dhënat në lidhje me disponimin e 2 (dy) Inxhinierëve Elektronik/Kompjuterik.

Sa më sipër ky kriter konsiderohet i papërmbushur.

Së treti, nuk plotëson kriterin 2.3.6, të kushteve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: Operatori Ekonomik duhet të disponojë në pronësi, me qira ose kontratë bashkëpunimi një automjet.

Për këtë duhet të paraqesë:

- Në rast të disponimit të automjetit në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - çertifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - siguracionin; - taksat vjetore.
- Ndërsa për mjete të marra me qira/kontratë bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/bashkëpunimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit.

KVO vëren se bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, si dhe bazuar në pikën 2/i të nenit 26 të VKM-së 285, ku parashikohet se Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti, dhe për të përmbushur këtë kriter operatorët ekonomik pjesmarrës duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së, të dhënat në lidhje me disponimin e të paktën një automjeti.

Autoriteti Kontraktor, mban në konsideratë se për plotësimin e këtij kriteri nuk mund të shqyrtojë dokumentacion tjetër përveç formularit përmbledhës të vetëdeklarimit pasi, ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorë ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së, dhe për vlerësimin e këtij kriteri KVO duhet ti referohet vetëm formularit përmbledhës të vetëdeklarimit KVO bazuar në pikën 1, të nenit 82, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se: “Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit”, bëri verifikimin në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, ku rezultoi se Operatori Ekonomik, nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të dhënat në lidhje me disponimin e në lidhje me disponimin e të paktën një automjeti. Sa më sipër ky kriter konsiderohet i papërmbushur.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nënin 76, pika 3/a dhe në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “NISATEL”, për mospërmbushje të kriterëve të veçanta kualifikuese. Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Operatori Ekonomik “NISATEL” me Nuis K26330201T, skualifikohet.”.

II.5. Referuar informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor dhe ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “NISATEL” SHPK rezultoi se në datën 15.04.2022, është

publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, prej të cilës rezulton fitues operatori ekonomik “*Erlis Marku*” PERSON FIZIK.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 19.04.2022 operatori ekonomik “*NISATEL*” SHPK ka paraqitur ankesë në rrugë elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik me numër A/2022/2103, protokolluar me tonën me nr. 802 prot, si dhe më datë 19.04.2022 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 802/2 prot, datë 20.04.2022 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “*NISATEL*” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.8. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 802/3 prot, datë 05.05.2022 “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “NISATEL” SHPK*”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor, të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, si dhe vendimi i autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “*NISATEL*” SHPK”.

II.9. Me shkresën nr. 7469/1 prot, datë 10.05.2022 me objekt: “*Kthim përgjigje*”, protokolluar me tonën me nr. 802/4 prot, datë 12.05.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “*NISATEL*” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar shkresës së mësipërme të autoritetit kontraktor informon si më poshtë vijon:

“... ”

VI. Me datë 14.04.2022, AK Bashkia Lezhë ka ngarkuar në SPE formularin e njoftimit të fituesit, i cili me datë 15.04.2022 është publikuar nga ana e APP-së në SPE.

VII. Me datë 26.04.2022, Titullari i Autoritetit Kontraktor pas kalimit të afatit 7 ditor të ankimit, ka miratuar raportin përfundimtar të procedurës së prokurimit me objekt: “*Shërbimi i Internetit në Bashkinë Lezhë për vitin 2022*”, duke shpallur përfundimisht fitues operatorin ekonomik “*Erlis Marku*” P/F.

VIII. Me datën 26.04.2022, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nënshkruar kontratën me Nr.4195/14 Prot, datë 26.04.2022 me objekt “Shërbimi i Internetit në Bashkinë Lezhë për vitin 2022” me OE “Erlis Marku” P/F.

IX. Me datë 26.04.2022, AK Bashkia Lezhë ka ngarkuar në SPE formularin e njoftimit të kontratës së nënshkruar i cili është publikuar edhe nga APP.

X. Në nenin 111, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik. 2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementët e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementët e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur. 4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik”.

XI. Në nenin 94, pika 1 dhe 2 të nenit 96 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”, parashikohet se:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është demtuar ose rrezikohet të demtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

2. Operatori ekonomik ankimes duhet të dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik”.

XII. Në Nenin 96, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”, parashikohet se: “Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimesi, personi përgjegjës për prokurimin konfirmon në bazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, nëse ankesa është paraqitur edhe pranë KPP-së.”.

XIII. Me datën 09.05.2022, AK Bashkia Lezhë u njoh me anë të shkresës nr. 802/3 datë 05.05.2022 të Komisionit të Prokurimit Publik, mbi ankesën e OE “NISATEL” SH.P.K.

Sa arsyetuar më sipër në kushtet e mos marrjes dijeni rreth ankesës së OE “NISATEL” Shpk, pasi pranë protokollit të Bashkisë Lezhë nuk është dorëzuar asnjë ankesë në formë të shkruar nga ky operator ekonomik ose dhe nga operatorë ekonomikë të tjerë të mundshëm, si dhe duke marrë në konsideratë praktikën e mëparshme ndërmjet Bashkisë Lezhë me Komisionin e Prokurimit Publik dhe me Agjencinë e Prokurimit Publik, në lidhje me ankesat për procedurat e prokurimit ku në çdo rast pas paraqitjes së ankesave nga ana e operatorëve ekonomikë në KPP është bërë menjëherë pezullimi i procedurës së prokurimit nga ana e KPP-së dhe nuk është lejuar publikimi i njoftimeve të autoritetit kontraktor, në SPE nga ana e APP-së, pa marrë më parë konfirmimin për heqjen nga pezullimi të procedurës së

prokurimit nga ana e KPP-së, AK pas njoftimit të fituesit në SPE dhe mbarimit të afateve të ankimit ka vijuar normalisht me lidhjen e kontratës për kryerjen e këtij shërbimi.

Në vijim, AK Bashkia Lezhë pasi u njoh me shkresën me Nr. 802/3 Protokolli, datë 05.05.2022, të Komisionit të Prokurimit Publik, mbi ankesën e OE "NISATEL" SH.P.K dhe me vënien në funksionin të Sistemit të Ankesave Elektronike (pa një njoftim zyrtar nga APP-ja), menjëherë verifikoi në SAE, ku rezultoi se OE "NISATEL" SH.P.K, ka paraqitur ankesë më datë 19.04.2022.

Me marrjen dijani për ankesën, titullari i autoritetit urdhëroi njësinë e prokurimit të pezullojë kontratën për kryerjen e shërbimit të internetit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga KPP, sipas parashikimeve të LPP-së.

Megjithëse AK e konsideron të drejtë vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik "Nisatel" SHPK, si dhe duke qënë se çdo vendim që AK mund të marrë në këtë fazë të procesit nuk krijon efekte për shkak të pamundësisë së pasqyrimin në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, kërkon nga Komisioni i Prokurimit Publik që krahas shqyrtimit dhe marrjes të një vendimi në lidhje me ankesën e OE, të shprehet edhe për vlefshmërinë e kontratës Nr. 4195/14 Prot, datë 26.04.2022 me objekt "Shërbimi i Internetit në Bashkinë Lezhë për vitin 2022", nëse është në kushtet e parashikimeve ligjore të nenit 119/1 të LPP 162/2020 ku parashikohet se: "I. Një kontratë do të konsiderohet absolutisht e pavlefshme në rastet e mëposhtme:

b) kur nuk janë zbatuar parashikimet e këtij ligji në lidhje ë zbatimin e procedurave të ankimit, duke privuar personal e interesuar për të ushtruar të drejtën e tyre për ankim dhe të shpallë këtë kontratë absolutisht të pavlefshme, pavarësisht interesit të përgjithshëm që ka AK për marrjen e këtij shërbimi."

Sqarojmë se AK Bashkia Lezhë në asnjë rast nuk ka pasur për qëllim kufizimin e operatorëve ekonomikë apo cënimin e të drejtave procedurale të tyre të ankimit por kjo situatë është krijuar si rezultat i mos azhornimit me njoftimet e KPP mbi vënien në përdorim të SAE, si dhe mos hyrjes (log in) në SAE gjatë periudhës së zhvillimit të procedurës deri me marrjen dijani nga shkresa e KPP.

Si përfundim AK Bashkia Lezhë, ju vë në dijeni se kontrata do të jetë e pezulluar deri në shqyrtimin dhe marrjen e një vendimi përfundimtar nga KPP, sipas parashikimeve të LPP-së."

II.10. Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 802/5 prot, datë 13.05.2022 "Kërkesë" dhe me shkresën nr. 802/7 prot, datë 23.06.2022, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar Agjencisë së Prokurimit Publik asistencë për rikthimin në Sistemin Elektronik të Prokurimit (SPE) të procedurës së mësipërme objekt-ankimimi, pasi kjo procedurë prokurimi nga verifikimet në SPE është arkivuar nga ana e autoritetit kontraktor. Për kërkesat e mësipërme Agjencia e Prokurimit Publik nuk ka dhënë asnjë përgjigje.

II.11. Në mungesë të një asistence nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik lidhur me rikthimin e procedurës objekt-ankimimi në Sistemin Elektronik të Prokurimit (SPE) Komisioni i Prokurimit me shkresën nr. 802/8 prot, datë 14.07.2022 "Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "NISATEL" SHPK", Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor, të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të

punës nga marrja e kësaj shkrese, dokumentacionin e ofertës të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “NISATEL” SHPK”, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë për arsyet e skualifikimit.

II.12. Me shkresën nr. 12885/1 prot, datë 15.07.2022 me objekt: “*Kthim përgjigje*”, protokolluar me tonën me nr. 802/9 prot, datë 18.07.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit, si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të shkresës nr. 802/8 prot, datë 14.07.2022, me lëndë “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankeseën e operatorit ekonomik “NISATEL” SH.P.K, në të cilën kërkohet dokumentacioni i ofertës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “NISATEL” SH.P.K, për procedurën e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar/Shërbime”, me Nr. REF-23685-03-31-2022, me objekt “Shërbimi i internetit në Bashkinë Lezhë për vitin 2022”, ju dërgojmë dokumentacionin e paraqitur në SPE, me datën 11.04.2022, nga operatori ekonomik “NISATEL” SH.P.K.

Gjithashtu ju bëjmë dije se Bashkia Lezhë me anë të shkresës nr. 7469/1 prot, datë 10/05/2022, ka dërguar informacionin e kërkuar me shkresën nr. 802/3 prot, datë 05.05.2022, të Komisionit të Prokurimit Publik mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankeseën e operatorit ekonomik “NISATEL” SH.P.K.

Po ashtu ju bëjmë me dije se pranë Bashkisë Lezhë nuk është paraqitur ankesë dhe si rrjedhojë asnjë dokumentacion lidhur me ankeseën as në rrugë shkrese apo në mënyre elektronike, nga ana e operatorit ekonomik “NISATEL” SH.P.K.

Bashkëngjitur gjeni në CD, dokumentacionin e paraqitur në SPE në formën elektronike (PDF), me datën 11.04.2022, nga operatori ekonomik “NISATEL” SH.P.K, si dhe shkresën e Bashkisë Lezhë nr. 7469/1 Prot, datë 10/05/2022, ku pasqyrohen arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “NISATEL” SH.P.K, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për operatorit ekonomik “NISATEL” SHPK se: “1. Në DST tek Kriteret e veçanta të kualifikimit në pikën 2.3.3 është vendosur si kriter se: Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar për pajisjet e kërkuara. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Për plotësimin e këtij kriteri Nisatel sh.p.k ka paraqitur Autorizim nga shoqëria “REG” sh.p.k e pajisur me NIUS L22210026U me adresë: “Rruga e Kavajës, ish-magazinat e Letër-

Kartonit, Tiranë”, si distributor i autorizuar për territorin e Republikës së Shqipërisë për shitjen e produkteve të markave MikroTik, UBNT dhe TENDA. Nisatel Sh.p.k ka paraqitur gjithashtu Autorizim nga shoqëria ”Albamedia” sh.p.k me NIUS K46811001V me adresë; “Rr. “Hiqmet Delvina”, Pallari 4, Tiranë”, për pajisjet TP-LINK. Autoriteti Kontraktor në rast të paraqitjes së Autorizimit nga Distributori zyrtar kërkon prej Operatorit Ekonomik edhe autorizim/ marrëveshje ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Një kërkesë kjo sa utopike po aq edhe anakronike nga ana e Autoritetit Kontraktor që: së pari, kërkon nga OE një dokument të cilin nuk e disponon ai vetë, pasi nuk është palë dhe ka shumë gjasa të mos i vihet në dispozicion pasi mund të përmbajë të dhëna konfidenciale midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar; dhe së dyti zhvillimi teknologjik dhe tregtar i ka çuar kompanitë e mëdha prodhuese të heqin dore nga procedurat klasike të marrëveshjeve të shkruara, pasi nga një vështrim në website zyrtare të kompanive prodhuese të pajisjeve teknologjike rezulton se një shoqëri për tu bërë distributor zyrtar ose rishitës i produkteve të tyre mjafton të plotësojë formularin on-line me të dhënat e tyre, porositë e produkteve si dhe pagesa bëhen gjithashtu on-line. Për të provuar lidhjen mes prodhuesit dhe distributorit mjafton të vizitohen faqet zyrtare të internetit të kompanive prodhuese si psh:

1. Ubiquiti Network Inc.ltd (UBNT) është një kompani teknologjike amerikane me qendër në New York. Në faqen zyrtare të kompanisë www.ui.com tek rubrika “Partners” shfaqet si rishitës i produkteve të saj shoqëria “REG” Sh.p.k në Shqipëri. Kjo provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit.

2. MikroTik është një prodhues i pajisjeve të rrjetit në Riga, Letoni. Në faqen zyrtare të kompanisë Mikrotik ltd, www.mikrotik.com shfaqet si një nga katër distributorët zyrtarë të pajisjeve në Shqipëri edhe shoqëria “REG” Sh.p.k. Kjo provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit.

3. TENDA Company Ltd është kompani e pajisjeve të rrjetit me qendër në Shenzhen Kinë. Në faqen zyrtare të kompanisë TENDA www.tendacn.com tek partnerët e saj ajo liston si distributor zyrtar edhe shoqërinë “REG” sh.p.k në Shqipëri. Kjo provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit. Pretendimi i Autoritetit Kontraktor se ky kriter nuk është plotësuar nuk qëndron pasi Nisatel Sh.p.k e ka përmbushur këtë kriter dhe kjo vërtetohet shumë lehtë pasi shoqëria “REG” sh.p.k shfaqet si distributor zyrtar ose rishitës tek faqet zyrtare të internetit të kompanive të lartëpërmendura fakt ky që provon lidhjen midis distributorit dhe prodhuesit. (Bashkëlidhur ankesës tek rubrika e dokumenteve do të gjeni edhe print screen nga faqet zyrtare të këtyre kompanive, ku shoqëria “REG” Sh.p.k shfaqet si distributor)”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” kriteri kualifikues i dhënë në pikën 2.3.3 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet si më poshtë:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar për pajisjet e kerkuara. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

III.1.5. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” janë përcaktuar specifikimet teknike të pajisjeve të nevojshme për ofrimin e shërbimit të internetit objekt-prokurimi, si më poshtë:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

1. Switch

Me 5 Porta

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi, "Type":	Switch Gigabit i Pa Menaxhueshëm 5 Porta
Numri i Portave Ethernet, "Number of Ethernet Ports" :	5 Porta Gigabit
Menyrat e Forward-im, "Forwarding modes":	Store-and-forward
Protokollet e Rrjetit IEEE, "IEEE Network Protocols":	IEEE 802.3 Ethernet IEEE 802.3ab 1000BASE-T
Certifikimi i produktit, "Certification":	CE mark
Aksesorët e Përfshirë, "Accessories Included":	Power Supply Power Adapter Quick Install Guide
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit

2. Switch

Me 8 Porta

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE

Tipi, "Type":	Switch Gigabit i Pa Menaxhueshëm 8 Porta
Numri i Portave Ethernet, "Number of Ethernet Ports":	8 Porta Gigabit
Mënyrat e Forward-im, "Forwarding modes":	Store-and-forward
Protokollet e Rrjetit IEEE, "IEEE Network Protocols":	IEEE 802.3 Ethernet IEEE 802.3ab 1000BASE-T
Certifikimi i Produktit, "Certification":	CE mark
Aksesorët e Përfshirë, "Accessories Included":	Power Supply Power Adapter Quick Install Guide
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	1 Vit

3. Router**Wireless Wi-Fi****KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE**

Tipi, "Type":	Router Wireless Wi-Fi Gigabit
Mënyrat e Operimit, "Operation Mode":	Wireless router modeAccess point mode Media bridge mode
"Klasa":	Min. AC 1900
Standartet WiFi, "WiFi Standards":	IEEE 802.11a/b/g/n/ac
Standardet e Rrjetit, "Network Standart":	IEEE 802.11a, IEEE 802.11b, IEEE 802.11g, IEEE 802.11n, IEEE 802.11ac, IPv4, IPv6
Portat, "Ports":	(1) Gigabit WAN Port (4) Gigabit LAN Ports (1) USB 2.0 ose USB 3.0
Lloji i lidhjes WAN, "WAN Connection Type":	Automatic IP, Static IP, PPPoE (MPPE supported), PPTP, L2TP
Niveli i Transferimit, "Transfer rate" :	Min. 300 Mbps
Protokollet e Rutimit, "Routing Protocols":	IPSec, L2TP or PPTP
Banda e Operimit, "Band":	Dual Band: 2.4 GHz & 5 GHz
Antenat, "Antennas":	Build-In or External
Siguria, "Security Features":	WEP 64/128-bit WPA2-Personal & Enterprise (AES/TKIP)WPS
Drita LED, "LED indicators":	Yes
Butona, "Buttons":	WPS Button Reset Button

Kërkesat e Sistemit të Operimit, "System Requirements":	Windows 7, 8 ose 10
Ushqimi, "Power Supply":	AC Input: 110 - 240 V AC (50/60 Hz)
Aksesorët, "Accessories Included":	Quick Start Guide CD-ROM with Documentation External Antennas (Opsional) Ethernet Cable Power Adapter Power Cord
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	1 Vit

4. SWITCH

L2 ME 24 PORTA

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
NDËRFAQET DHE KARAKTERISTIKAT HARDWARE	
Porta 10/100/1000Mbps RJ45 (Auto Negocim /Auto MDI/MDIX)	≥ 24
Porta SFP	Opsionale
Porta Uplink (baker/fiber) 100/1000Mbps SFP Slots	2-4 / Combo Opsionale
Porta Combo	Opsionale
Porta Console RJ-45/RS-232	1
Instalimi në Rack	19" Rack Mountable
HYRJE "INPUT"	
Tensioni Nominal	100~240 V AC
Frekuenca	50/60 Hz
PERFORMANCA DHE FLEKSIBILITETI	
Switching Capacity	≥ 96 Gbps
Throughput	≥ 70 Mpps
Flash Memory	128 MB
RAM	512 MB
Jumbo Frame	Opsionale
Tabelë të Adresave MAC	16k
Fan	Opsionale
STANDARDET	
IEEE 802.3 - 10BASE-T	Po
IEEE 802.3u - 100BASE-TX	Po
IEEE 802.3ab - 1000BASE-T	Po
IEEE802.3z - 1000BASE-X	Opsionale
IEEE 802.3ad - Agregim linku	Po

IEEE 802.3x - full duplex on 10BASE-T, 100BASE-TX, and 1000BASE-T ports	Po
IEEE 802.1d - Spanning Tree Protocol	Po
IEEE 802.1s - multi STP	Po
IEEE 802.1w - RSTP	Po
IEEE 802.1q - VLAN	Po
IEEE 802.1x - Port-based Network Access Control	Po
IEEE 802.1p - QoS Classification	Opsionale
IEEE 802.3af - PoE	Opsionale
IEEE 802.3at - PoE	Opsionale
SISTEMI OPERATIV	
Të Jetë i Orientuar për Operacionet LAN	Po
Të Ketë Mundësi për Upgrade	Po
QUALITY OF SERVICE	
Priority Queues	Po
Queue Scheduling	SP, WRR
VECORITË NË LAYER 2 DHE 3	
IGMP Snooping	V1/V2/V3
Spanning Tree	STP/RSTP/MSTP
LLDP	Po
BPDU Filtering/Guard	Po
Detektim të Loopback	Po
802.3x Flow Control	Po
VLAN ID	4k, (Voice VLAN Opsional)
Agregim të Linkeve	802.3ad LACP
Adresimi IPv6	Po
DHCP/BOOTP, DHCP Snooping, DHCP Option82 për klientët	Po
Dynamic ARP inspection (DAI)/ Dynamic ARP Protection (DAP)	Po
Limitim të Shpejtësisë	Port/Flow
Policy-Based Routing (PBR)	Jo
Routimi	Jo
SIGURIA	
Access Control List	Po
TCP/UDP Ports	Po
Protokollin DSCP	Po
Authentication	TACACS+, RADIUS, IEEE 802.1X, Port/MAC, SSH v1/v2, SSLv2/v3/TLSv1
Storm Control	Broadcast, Multicast, Unicast
MENAXHIMI	
Web-based GUI dhe CLI	Po

RS-232 Console / RJ-45 Console	Po
Telnet, SSH	Po
Monitorim të CPU	Po
SNTP / NTP	Po
Upgrade të Firmware	TFTP ose ndërfaqes Web
Ekran LED	Opsionale
SNMP v1/v2c/v3	Po
SYSLOG	Po
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit

Ndwrsa nw shtojcën 7 “Termet e referencws” janw pwrctuar objekti, qwllimi dhe mwnyra e ofrimit tw shwrbimit tw internetit objekt-prokurimi, si më poshtë:

Shtojca 7

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

TERMAT E REFERENCES PER SHERBIM INTERNETI:

Per kryerjene sherbimit kerkohet qe Linja me fiber te jete sipas tabelës së mëposhteme:

Nr	Vendi	Lloji	Bandwidth	Limiti
1	Bashkia (Duke përfshirë edhe zyrat e reja)	Fiber Optike me IP Statike	50/50 mbps	Pa Limit
2	Zjarrefiksja	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit
3	Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjorja	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit
4	Njësia Administrative Shenkoll	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit
5	Njësia Administrative Shengjin	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit
6	Njësia Administrative Kallmet	Fiber Optike/ Radio Link	16 mbps	Pa Limit
7	Njësia Administrative Balldre	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit
8	Njësia Administrative Zejmen	Fiber Optike/ Radio Link	16 mbps	Pa Limit
9	Njësia Administrative Kolsh	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit
10	Njësia Administrative Blinisht	Fiber Optike/ Radio Link	16 mbps	Pa Limit
11	Njësia Administrative Dajç	Fiber Optike/ Radio Link	16 mbps	Pa Limit
12	Njësia Administrative Ungrej	Radio Link	16 mbps	Pa Limit
13	Drejtoria e Shërbimeve	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit
14	Biblioteka	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit

15	Urbanistika	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit
16	Drejtoria e Arsimit dhe Turizmit	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit
17	Drejtoria e Aseteve	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit
18	Arkiva e Bashkise	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit
19	Policia Bashkiake	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit
20	Qendra per njerezit me aftesi ndryshe “ Trendafilat “	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit
21	Qendra Kulturore e Femijeve	Fiber Optike	16 mbps	Pa Limit
22	Bashkia	Telefoni Fikse + VDSL (BackUp)	50 mbps	500 GB Limit

Lloji i lidhjes te percaktohet nga Kontraktori sipas specifikimeve ne tabelen e mesiperme.

Pajisjet fizike qe i nevojiten mirefunksionimit te rrjetit dhe mirembatja e tyre do realizohen nga Kontraktori 24/7 dite te javes.

Kontraktori duhet te jete i Çertifikuar per ofrimin e rrjeteve dhe sherbimeve publike te komunikimeve elektronike nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Lidhja e internetit ne Njesite Aadministrative dhe Drejtorite (Sipas Tabeles) duhet te kryhet brenda 48 oreve nga firmosja e kontrates.

Ne rast defekti kontraktori duhet te kryeje riparimin ose zvendesimin e paisjeve qe sherbejne per mirefunksionimin e rrjetit (switch, kabull dhe koka rrjeti) brenda 2 oreve nga momenti i marrjes se njoftimit nga IT-ja e Bashkise Lezhe.

Duke konsideruar terrenin, Kontraktori duhet te paraqese nje projekt ne lidhje me menyren e ofrimit te sherbimit.

Bashkia Lezhe se bashku me Drejtorite te cilat nuk jane te ndodhen brenda godines kryesore te Bashkise Lezhe duhet te lidhen ne menyre te tille qe te mund te menaxhohen nga Mikrotiku i Bashkise.

Godina e Bashkise do kete 1 numer fiks per thirrje kombetare dhe nderkombetare, per thirrjet kombetare thirrjet do jene pa limit, brenda nje tarife fikse dhe thirrjet nderkombetare sipas konsumit.

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “NISATEL” SHPK në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Autorizim Distributori të datës 08.04.2022, të lëshuar nga kompania “Albamedia’ SHPK me përmbajtje si në vijim: “Albamedia shpk, në cilësinë e distributorit të autorizuar për “TP-LINK Netëorks Hungary Kftp link”, autorizon kompaninë “Nisatel’ shpk me adresë: Rr “Pelivan Leskaj”, Vlorë të ofertojë në procedurën me

autoritet kontraktor Bashkia Lezhë dhe objekt prokurimi “Shërbim i internetit në Bashkinë Lezhë për vitin 2022”. Albamedia shpk autorizon ‘Nisatel’ shpk të ofertojë, negociojë dhe të nënshkruaj kontratë me autoritetin kontraktor për produktin e më poshtë:

1- ROUTER TP-LINK Archer C64.”.

- Autorizim të datës 08.04.2022, të lëshuar nga kompania “REG” SHPK me përmbajtje si në vijim: “Kompania REG SHPK e pajisur me NIPT L222210026U, adresë; “Rr. Kavajës, ish-magazinat Letër-Kartoni, Tiranë”, e cila është distributor i autorizuar për territorin e Shqipërisë për shijen e produkteve të markave MikrotikTik, UBNT, Tenda, autorizon kompaninë “Nisatel’ shpk me adresë: Rr “Pelivan Leskaj”, kat 2, Vlorë, të paraqesë ofertë në tenderin me objekt “Shërbim i internetit në Bashkinë Lezhë për vitin 2022”, datë 11 Prill 2022.

Gjithashtu kompania Nisatel shpk autorizohet të negociojë, të nënshkruaj kontratë me ju, si dhe të tregtojë produktet e markës MikrotikTik, UBNT, Tenda.”.

III.1.4. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” tw ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.1.5. Neni 3 “Parime të përgjithshme” tw ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.6. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”.

III.1.7. Në nenin 41, pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

III.1.8. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo

sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardevë kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.1.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në

procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.10. Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor për produktet e nevojshme për ofrimin e shërbimit të interneti si: *“Switch me 5 Porta; Switch me 8 Porta; Router Wireless Wi-Fi dhe SWITCH L2 me 24 Porta”*, të dhëna në shtojcën 5 të dokumentave të tenderit, ka përcaktuar që ofertuesit për këto produkte duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi i këtyre produkteve, por në rastin kur paraqitet autorizim nga distributori është e detyrueshme që të paraqitet autorizimi ose akti i marrëveshjes ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar, ndërkohë që për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ankimues ka paraqitur autorizim nga distributori i autorizuar “Albamedia” SHPK për produktin “ROUTER TP-LINK Archer C64” të prodhuar nga prodhuesi “TP-LINK Netëorks Hungary Kft link”, si dhe autorizim nga distributori i autorizuar “REG” SHPK për produktet e markave MikroTik, UBNT dhe Tenda, por pa deklaruar se kush është prodhuesi i këtyre markave dhe për më tepër pa deklaruar se cilat nga produktet e përcaktuara në shtojcën 5 të dokumentave të tenderit tregton kompania “REG” SHPK.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri kualifikues i përcaktuar në pikën 2.3.3 të shtojcës 8 të dokumentave të tenderit nuk është përmbushur nga ana e ofertuesit “NISATEL” SHPK, pasi nuk autorizimet e paraqitura nga ky ofertor konsiderohen si autorizime të lëshuara nga distributorë të autorizuar, por në rastin e autorizimit të lëshuar nga kompania “Albamedia” SHPK mungon dokumenti i lëshuar nga kompania prodhuese “TP-LINK Netëorks Hungary Kft link” që vërteton se kjo kompani “Albamedia” SHPK është distributor i autorizuar, ndërsa në rastin e autorizimit të lëshuar nga kompania “REG” SHPK nuk vërtetohet se kush është prodhuesi i produkteve të markave MikroTik, UBNT e Tenda dhe për më tepër mungon një dokument që të vërtetojë se kush është prodhuesi i këtyre markave, si dhe që të vërtetojë se kjo kompani është distributor i autorizuar nga prodhuesi i këtyre markave.

Për më tepër, operatori ekonomik ankimues në pretendimet e ngritura në ankesën e paraqitur ku kundërshton skualifikimin e tij për mospërmbushjen e këtij kriteri kualifikues shprehet se: *“Ubiquiti Network Inc.ltd (UBNT) është një kompani teknologjike amerikane me qendër në New York. Në faqen zyrtare të kompanisë www.ui.com tek rubrika “Partners” shfaqet si rishitës i produkteve të saj shoqëria “REG” Sh.p.k në Shqipëri. Kjo provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit. 2. MikroTik është një prodhues i pajisjeve të rrjetit në Riga, Letoni. Në faqen zyrtare të kompanisë Mikrotik ltd, www.mikrotik.com shfaqet si një nga katër distributorët zyrtarë të pajisjeve në Shqipëri edhe shoqëria “REG” Sh.p.k. Kjo provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit. 3. TENDA Company Ltd është kompani e pajisjeve*

të rrjetit me qendër në Shenzhen Kinë. Në faqen zyrtare të kompanisë TENDA www.tendacn.com”, duke deklaruar në mënyrë të njëanshme që prodhuesit e produkteve të markave MikroTik, UBNT e Tenda janë përkatësisht kompanitë prodhuese MikroTik Riga Letoni; Ubiquiti Netëork Inc.ltd dhe TENDA Company Ltd, ndërkohë që në autorizimin e lëshuar nga shoqëria “REG” SHPK nuk indentifikohet se distributor i kujt prodhuesi është kjo kompani, si dhe nuk ka lëshuar asnjë dokument që të vërtetojë lidhjen me prodhuesit e këtyre produkteve.

Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Nisatel” SHPK në këtë procedurë prokurimi, nuk mund të konsiderohet i plotë dhe i vlefshëm për sa kohë që nuk provohet me një dokument konkret lidhja mes kompanisë “Albamedia” SHPK dhe “TP-LINK Netëorks Hungary Kftp link” dhe lidhja mes kompanisë “REG” SHPK dhe prodhuesit apo prodhuesve të produkteve të markave MikroTik, UBNT e Tenda.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues “Nisatel” SHPK nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Nisatel” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar / shërbime”, me Nr. REF-23685-03-31-2022, me objekt “Shërbimi i Internetit në Bashkinë Lezhë për vitin 2022” me fond limit 1.001.572 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 11.04.2022, nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Nisatel” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

